

REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS
DALLË
Nr. Proti: 01-020/p8-39/23
En. Str.:
Nr. i fç.:
Datum: 04. 07. 2023.
Data:
ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



Duke u bazuar në nenin 12,17 i 40 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenet 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës nr 01/898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i komunës së Shtërpçe në seancën e mbajtur më datën 29.12.2022, ka marr këtë:

VENDIM

Për aprovimin e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2023

1. Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit sipas tekstit bashkangjitur me këtë vendim.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit e Kuvendit



Kryesuesi Kuvendit

Predrag Grbic

REPUBLIKA E KOSOVES
OPSTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTERPCES

01-020/08-37/23

06.09.2023

ŠTRPCE - SHTERPCË

Plani I punës së kuvendit të Komunës së Shtërpcës për vitin

2023

VËREJTJET HYRËSE:

Kuvendi komunal është organi më i lartë i komunës i cili kryen funksionet themelore të qeverisë lokale, të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe me statutin e komunës. Kuvendi komunal përfaqëson dhe mbron interesat e qytetarëve aq sa është e organizuar mirë, e përgatitur dhe e suksesshme në marrjen e vendimeve të drejta të cilat janë me rëndësi për qytetarët e komunës dhe organet e qeverisë lokale. Plani i punës së kuvendit komunal për vitin vijues përmban renditjen e shqyrtimeve dhe aprovimeve të vendimeve të rëndësishme, rregulloreve komunale, raporteve, strategjive, aprovimin e buxhetit dhe temat tjera të cilat sipasligjit do të gjenden në rendin e ditës së kuvendit komunal në vitin 2020.

Andaj, qëllimi i këtij dokumenti është lehtësimi dhe avancimi i punës së kuvendit komunal me qëllim që ajo të jetë sa më funksionale, më mirë e organizuar, më transparente dhe e suksesshme në punën e saj.

KUVENDI KOMUNAL:

Kuvendi komunal është organ më i lartë ligjdhënës dhe përfaqësues i komunës i cili drejtpërdrejtë në zgjedhje zgjedhet nga qytetarët. Kuvendi komunal përbëhet nga këshilltarët, kryesuesi i kuvendit dhe zëvendës kryesuesi për komunitete. Kuvendi komunal Shtërpecë numëron nëntëmbëdhjetë (19) këshilltarë. Këshilltarët nga radhët e veta me votë të fshehtë zgjedhin kryesuesin e kuvendit, mandati i të cilit është i njëjtë sikurse mandati i këshilltarëve të kuvendit komuna (4 vite). Zëvendës kryesuesi për komunitete i takon kandidatit të partisë politike, i cili në zgjedhjet ka fituar më shumë vota në komunitetin pakicë në komunë.

E drejta është si dhe obligimi i këshilltarëve që të marrin pjesë në punën e kuvendit komunal dhe komiteteve të tij, propozon kuvendit diskutimin lidhur me çështjet e caktuara, parashtron propozim vendime dhe akte tjera nga kompetencat e kuvendit komunal dhe jep amandmane në propozimet e rregullave , parashtron pyetje lidhur me punën e organeve komunale dhe merr pjesë në aktivitetet tjera të kuvendit komunal.

Seancat e kuvendit komunal janë të hapura për qytetarë, media, organizata joqeveritare, grupet e interesit dhe publikun e gjerë përveç në rastet e seancave të mbyllura të cilat janë të parapara me ligj. Kuvendi komunal do të mbajë së paku dhjetë seanca në vit, ku prej tyre pesë duhet të mbahen në gjashtë muajt e parë të vitit, siç është e paraparë me Rregulloren e punës.

KOMPETENCAT E KUVENDIT KOMUNAL:

Kuvendi komunal mund të aprovon akte në kuadër të kompetencave të veta. Aktet e kuvendit komunal vlejnë në territorin e komunës e cila i ka aprovuar këto akte. Disa nga aktet më të rëndësishëm të cilat i aprovon kuvendi komunal janë:

1. Statuti i komunës,
2. Rregullorja e punës së kuvendit komunal,
3. Rregulloret komunale,
4. Aktet tjera juridike të cilat janë të domosdoshme për punë efikase dhe funksionale të komunës.

Kuvendi komunal punën e vet e bazon në ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, statutin dhe aktet tjera nënligjore. Kuvendi komunal nuk mund të bart autorizime të cilat janë vetëm nën kompetencat e kuvendit komunal, e ato janë:

1. Aprovimin, ndryshimin dhe revokimin e statutin të komunës, rregullores së punës së kuvendit komunal dhe rregulloreve komunale,

2. Lejimin e buxhetit dhe planeve investuese,
3. Lejimin e çështjeve tjera financiare të cilat janë të rezervuara për kuvendit komunal sipas statutit apo rregullores së punës.
4. Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor,
5. Themelimin e komisioneve të përhershme të kuvendit,
6. Zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të kuvendit komunal,
7. Lejimin e nivelit të taksave dhe ndëshkimeve,
8. Vendosjen dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujt e nderit,
9. Emërtimin dhe ndryshimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në komunë,
10. Lejimin e marrëveshjeve ndërkomunale dhe komunale,
11. Marrja e vendimeve për kyçjen e shoqatave përfaqësuese të komunave, dhe
12. Të gjitha përgjegjësit tjera të parapara me rregullat pozitive-juridike të Kosovës.

KALENDARI I AKTIVITETEVE:

JANAR	Seanca e parë e Kuvendit Komunal---- _____ JANAR 2023. Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për zyrën e prokurimit për vitin 2023 4. Raporti i kryesuesit të kuvendit për realizimin e planit të punës për vitin 2022 5. Shqyrtimi i projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave dhe marrja e vendimit për hapjen e debatit publik. 6. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse:
SHKURT	Seanca e dytë e Kuvendit Komunal SHKURT ----- _____ 2023. Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Raporti i Komitetit Komunal për Siguri ne Bashkesi. 4. Raporti vjetor i punës së kryetarit 5. Prezantimi i raportit përfundimtar financiar i kryetarit për vitin 2022 6. Raporti vjetor i Komitetit për Politik dhe Financa 7. Shqyrtimi i dhe aprovimi i i projekt rregullores për menaxhimin e mbeturinave . 8. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse:
MARS	Seanca e tretë e Kuvendit Komunal MARS----- _____ 2023. Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Plani i Veprimit për Transparencën për vitin 2023 4. Të ndryshme

	Aktivitetet përcjellëse:
PRILL	Seanca e katërt e Kuvendit Komunal PRILL ----- 2023. Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Prezantimi dhe shqyrtimi i raportit tremujor financiar për periudhën janar – mars 2023 dhe raporti mbi nivelin e pagesës të hyrave vetanake 4. Formimi i grupit punues për hartimin e planit aksionar për pjesëmarrje të publikut në aprovimin e buxhetit për vitin 2023-2025 5. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse:
MAJ	Seanca e pestë e Kuvendit Komunal MAJ----- 2023. Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Aprovimi i planit aksionar për pjesëmarrje të publikut në aprovimin e buxhetit për vitin 2023-2025 4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të integritetit 2023-2027 5. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse:
QERSHOR	Seanca e gjashtë e Kuvendit Komunal QERSHOR ----- 2023. Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2023-2025 4. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse: 1. Debati publik mbi draft kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025.
KORRIK	Seanca e shtatë e Kuvendit Komunal KORRIK ----- 2023. Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Raporti gjashtëmujor i punës së kryetarit 4. Prezantimi dhe shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar për periudhën janar – qershor 2023 dhe raporti mbi nivelin e pagesës të hyrave vetanake 5. Raporti gjashtëmujor i Komitetit për Siguri në Bashkësi. 6. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse: 1. Debati publik për propozim buxhetin e komunës për vitin 2023-2025 2. Debati publik për rregulloren e komunës mbi tatimin në pronë për vitin 2023
GUSHT	1. PUSHIMI VEROR

SHTATOR	Seanca e tetë e Kuvendit Komunal SHTATOR ----- 2023.
	Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Aprovimi i draft buxhetit për vitin 2024 4. Aprovimi propozim rregullores komunale për tatimin ne pronë për vitin 2024 5. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse: 6. Debati i trete publik për propozim buxhetin komunal 7. Debati publik për investimet kapitale për vitin 2023-2025
	Seanca e nëntë e Kuvendit Komunal . TETOR ----- 2023.
TETOR	Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Prezantimi i raportit nëntëmuor financiar për periudhën janar – shtator 2023dhe raporti mbi pagesën e të hyrave vetanake 4. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse:
	Seanca e dhjetë e Kuvendit Komunal NËNTOR----- 2023.
NËNTOR	Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Formimi i komisionit për hartimin e planit të punës së kuvendit 4. Të ndryshme Aktivitetet përcjellëse:
	Seanca e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal DHJETOR ----- 2023.
DHJETOR	Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar 3. Aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2024 4. Të ndryshme